

L I G J
Nr.8088, datë 21.3.1996

PËR SHOQERITË E BASHKËPUNIMIT RECIPROK
(ndryshuar me ligjet: nr.9039, datë 27.3.2003, nr.9747, datë 31.5.2007.)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore Kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizim

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok janë bashkime vullnetare të personave fizikë ose juridikë, për kryerjen e veprimeve ekonomike në fusha të ndryshme.

Neni 2
Ligjet e referimit

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok rregullohen nga dispozitat e këtij ligji. Shoqëri të bashkëpunimit reciprok për fusha veprimtarie të caktuara mund të rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 3
Pavarësia në marrjen e vendimeve

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok janë të lira të ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe të marrin vendime përkatëse, brenda kuadrit të akteve ligjore e nënligjore.

Neni 4
Personaliteti juridik

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok janë persona juridikë. Çdo shoqëri e bashkëpunimit reciprok ka vulën e saj.

Neni 5
Afati i veprimtarisë
(Shfuqizuar fjalia e parë me Ligjin Nr. 9039, datë 29.03.2003)

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok duhet të caktojnë afatin e veprimtarisë në statutet e tyre. Shoqëria mund të vendosë zgjatjen ose përsëritjen e afatit të caktuar.

Neni 6
Territori

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok kanë territorin e tyre përkatës, shtrirja e të cilit përcaktohet në statutin e shoqërisë.

Neni 7
Selia

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok kanë selinë e tyre, e cila përcaktohet në statutin e shoqërisë.

Neni 8
Emërtimi
(Ndryshuar fjalia e dytë me Ligjin Nr.9747, datë 31.05.2007)

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok kanë emërtimin e tyre që caktohet në statut. Emërtimi i shoqërisë në shkresat, publikimet dhe të gjitha dokumentet e saj duhet të paraprihet nga fjalët "shoqëritë e bashkëpunimit reciprok", pas të cilave shënohet emri i saj dhe numri i regjistrimit, i marrë nga organi i ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e tyre."

Neni 9
Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë së bashkëpunimit reciprok është realizimi i veprimtarisë ekonomike bashkërisht nga anëtarët e saj. Veprimtaritë ekonomike mund të jenë të ndryshme, si në fushën e prodhimit, të shitblerjes së mallrave, në fushën e shërbimeve, të kreditit, në fushën e ndërtimeve, si dhe në të gjitha fushat e tjera. Qëllimi i veprimtarisë së shoqërisë së bashkëpunimit reciprok është ndihma e ndërsjellë e anëtarëve që bëjnë pjesë në to.

Neni 10
Kryerja e veprimeve

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok mund të kryejnë vetëm veprime që përfshihen në objektin e veprimtarisë së përcaktuar në statutin e tyre, si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm për plotësimin e këtij objekti.

Neni 11
Bashkimi i shoqërive
(Shtuar një fjali me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok mund të formojnë ndërmjet tyre bashkime ose shoqëri të reja, të cilat rregullohen nga ky ligj. Llojet e bashkimeve të shoqërive të bashkëpunimit reciprok, emërtimet, qëllimet dhe objekti i veprimtarisë përcaktohet në statutet e tyre.

Neni 12
Pjesëmarrja

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok mund të marrin pjesë e të jenë anëtarë në bashkimet e shoqërive të bashkëpunimit reciprok a në çdo shoqëri tjetër, ose të krijojnë edhe shoqëri të reja në përputhje me kërkesat e ligjit përkatës.

Neni 12/1
Statuti i shoqërisë
(Shtuar me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok kanë statutin e tyre, i cili përmban, veç të tjerave, edhe:

- a) emrin dhe selinë e shoqërisë;
- b) objektin e shoqërisë;
- c) rregullat që përcaktojnë nëse anëtarët e shoqërisë bëjnë pagesa shtesë, në mënyrë të pakufizuar/të kufizuar, deri në një shumë të caktuar (kufiri maksimal i detyrimit), për pasurinë, që

është objekt i falimentimit, në rastin kur kreditorëve nuk mund t'u përmbushen detyrimet gjatë procesit të falimentimit;

ç) rregullat për formën e thirrjes së asamblesë së përgjithshme të anëtarëve, rregullat e dokumentimit me shkrim të vendimeve, rregullat për drejtuesin e asamblesë së përgjithshme. Thirrja e asamblesë së përgjithshme bëhet nëpërmjet njoftimit të anëtarëve nga organi i shoqërisë ose nëpërmjet njoftimit në organet e medias;

d) rregullat për formën e njoftimeve të shoqërisë, si dhe rregullat për njoftimin në organet e medias;

dh) sasinë e kontributeve që derdhi secili anëtar (kuotat e kapitalit), si dhe pagesat për çdo kuotë kapitali, për të cilat është i detyruar çdo anëtar;

e) krijimin e rezervave të përmendura në nenet 43 e 44;

ë) rregullat sipas së cilave veprimtaria e shoqërisë kufizohet për një periudhë të caktuar kohe;

f) lidhjen që ekziston ndërmjet anëtarësimit dhe zgjatjes së tij me vendqëndrimin brenda një qarku të caktuar;

g) rregullat për rrethanat në të cilat asambleja e përgjithshme nuk merr vendime me shumicë të thjeshtë votash;

gj) rastet e përjashtimit të anëtarëve nga shoqëria;

h) kriteret e shpërndarjes së kontributeve në natyrë.

Neni 13

Veprimet me të tretët

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok i kryejnë veprimet me anëtarët e shoqërisë, ose edhe me persona të tretë, që nuk janë anëtarë të shoqërisë, sipas përcaktimeve të parashikuara në statutet e tyre.

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok lejohet të kryejnë veprime me persona të tretë që nuk janë anëtarë të shoqërisë vetëm në kushtet që vijojnë:

- Veprimet me të tretët duhet të përputhen me veprimet që figurojnë në objektin e veprimtarisë së shoqërisë së bashkëpunimit reciprok.

- Veprimet me të tretët nuk mund të kryhen në kushte më të favorshme për të tretët në raport me anëtarët e shoqërisë.

- Xhiroja e secilës veprimtari, që përcaktohet në statutin e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok, duhet të realizohet jo më pak se gjysma me anëtarët e shoqërisë dhe vetëm pjesa tjetër me persona të tretë.

- Veprimet e realizuara me personat e tretë duhet të kontabilizohen në veçanti e qartë.

KREU II

ANËTARËT E SHOQËRISË

Neni 14

Anëtarët

Anëtarë të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok janë persona fizikë ose juridikë, të cilët dëshirojnë të realizojnë bashkërisht veprime ekonomike në gjirin e shoqërisë dhe që pranojnë statutin e miratuar nga shoqëria e bashkëpunimit reciprok.

Neni 15

Numri i anëtarëve

(Zëvendësuar një fjalë me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok, për t'u themeluar, duhet të ketë jo më pak se 3 anëtarë. Numri i anëtarëve të shoqërisë gjatë qenies së saj mund të rritet pa asnjë kufizim. Ky numër mund edhe të pakësohet, por gjithmonë me kusht që të mbeten jo më pak se 7 anëtarë të shoqërisë. Kur shoqërisë i mbeten jo më pak se 7 anëtarë dhe numri i tyre nuk plotësohet gjatë një viti, shoqëria prishet.

Bashkimet e shoqërive të bashkëpunimit reciprok, për t'u themeluar, duhet të kenë jo më pak

se dy shoqëri të tilla.

Neni 16

Kushtet e pranimit

Anëtar i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok mund të bëhet çdo person fizik ose juridik që plotëson kushtet për pranim, të përcaktuara në statutin e shoqërisë. Kërkesa për pranim bëhet me shkrim dhe i paraqitet për shqyrtim këshillit administrativ të shoqërisë, i cili është organi kompetent që vendos pranimin ose jo të kërkesës.

Neni 17

Humbja e cilësisë së anëtarit

(Ndryshuar me Ligjin Nr.9030, datë 29.03.2003)

Anëtarësimi në shoqëri humbet kur anëtari heq dorë, përjashtohet nga shoqëria ose vdes. Çdo anëtar është i detyruar të njoftojë me shkrim, të paktën tre muaj më parë, heqjen dorë nga shoqëria. Largimi nga shoqëria bëhet vetëm në fund të vitit fiskal.

Anëtari i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok që jep dorëheqjen ose që përjashtohet, mbetet i detyruar ndaj detyrimeve të shoqërisë për një periudhë prej pesë vjetësh në raport me pjesët që ka ai në kapitalin e shoqërisë.

Duke filluar nga çasti i njoftimit të vendimit për largim, anëtari nuk mund të marrë më pjesë në asamblenë e përgjithshme dhe nuk mund të jetë më anëtar i këshillit administrativ ose i këshillit mbikëqyrës

Neni 18

Regjistrimi i pranimeve

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok mban një regjistër, i cili përmban datën e pranimit të çdo anëtarit, si dhe datën në të cilën ai humbet cilësinë e anëtarit.

Neni 19

Të drejtat dhe detyrimet

Anëtarët e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok kanë të drejta dhe detyra të barabarta, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të shoqërisë parashikohen në statutin e saj.

Neni 20

Masat disiplinore

Llojet e masave disiplinore që merren ndaj anëtarëve të shoqërisë përcaktohen në statutin e saj. Masa më e rëndë disiplinore është përjashtimi nga shoqëria e bashkëpunimit reciprok.

Masat disiplinore jepen për shkeljet e parashikuara në statutin e shoqërisë.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 21

Organet drejtuese

Organet e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok janë asambleja e përgjithshme, këshilli administrativ dhe këshilli mbikëqyrës. Në rastin e një shoqërie me shtrirje territoriale të madhe, statuti mund të parashikojë si organe edhe asamblenë rajonale.

Neni 22
Asambleja e përgjithshme

Asambleja e përgjithshme përbëhet nga gjithë anëtarët e shoqërisë dhe është organi vendimor i shoqërisë. Vendimet e asamblesë janë të detyrueshme për çdo anëtar të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok.

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme është e vlefshme, kur në të marrin pjesë më shumë se tre të katërtat e numrit të anëtarëve. Vendimet e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme janë të vlefshme, kur miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm. Asambleja e përgjithshme është e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asambleja e përgjithshme e zakonshme vjetore thirret një herë në vit nga këshilli administrativ. Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme thirret nga këshilli administrativ ose nga këshilli mbikëqyrës ose kur atë e kërkon të paktën 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok. Asambleja e përgjithshme e zakonshme thirret nga këshilli administrativ ose nga këshilli mbikëqyrës, ose kur kërkohet nga 1/10 e numri të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 23
E drejta e votes
(Shtuar paragrafi i dytë me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Çdo anëtar i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok, në kohën e ushtrimit të veprimtarisë së asamblesë së përgjithshme, ka të drejtën e një vote. Në bashkimet e shoqërive të bashkëpunimit reciprok e drejta për numrin e votave që do të ketë çdo anëtar, caktohet në statutet e tyre.

Nëse një anëtar nuk merr ose nuk mund të marrë pjesë në asamblenë e përgjithshme, autorizon me prokurë të posaçme një person tjetër të ushtrojë të drejtën e votës së tij në asamblenë e përgjithshme

Neni 24
Shpërblimi i funksioneve

Funksionet e anëtarëve të shoqërisë në organet e ndryshme të saj ushtrohen, si rregull, pa pagesë. Shpenzimet që anëtarët bëjnë gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve, paguhën. Në statutet e shoqërive të bashkëpunimit reciprok, kur është e nevojshme, caktohen funksionet e pagueshme.

Neni 25
Asambleja e përgjithshme e zakonshme vjetore

Asambleja e përgjithshme e zakonshme vjetore mbledhet brenda katër muajve pas mbarimit të veprimtarisë së vitit kalendarik. Ajo shqyrton raportin e gjendjes financiare të shoqërisë, raportin e veprimtarisë së këshillit administrativ, si dhe të gjitha çështjet e tjera të veprimtarisë ekonomike e të drejtimit, që çmohen të rëndësishme prej saj. Për çështjet që shqyrton, asambleja merr vendimet përkatëse.

Anëtarët e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok mund të mbledhen në çdo kohë në një asamble të përgjithshme të zakonshme, për të marrë vendime për çështje të tjera nga ato që janë kompetencë e asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme.

Neni 26
Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mbledhet në çdo kohë, si në rastet kur paraqitet nevoja që të vendosë për ndryshimin e statutit të shoqërisë, për prishjen e shoqërisë, për transformimin e shoqërisë në një formë tjetër, ose për pjesëmarrjen në bashkimet e shoqërive të bashkëpunimit reciprok.

Neni 27
Asambleja rajonale

Asambleja rajonale mblidhet në çdo rajon para asamblesë së përgjithshme, për të debatuar në lidhje me çështjet e rendit të ditës të asamblesë së përgjithshme, por nuk merr vendim për to. Asambletë rajonale caktojnë të deleguarit që përfaqësojnë anëtarët e shoqërisë në asamblesë të përgjithshme. Numri i të deleguarve të çdo rajoni caktohet nga këshilli administrativ i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok.

Neni 28
Këshilli administrativ
(Shtuar në paragrafin katërt 2 paragrafë me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Këshilli administrativ përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, që zgjidhen nga asambleja e përgjithshme ndër anëtarët e shoqërisë, për një periudhë të caktuar në statut dhe që mund të hiqen në çdo kohë prej saj. Këshilli administrativ zgjedh nga gjiri i tij kryetarin dhe zëvendësin e tij.

Për bashkimet e shoqërive të bashkëpunimit reciprok rregullat për përbërjen e këshillit administrativ, periudhën e veprimtarisë dhe për shkarkimin e anëtarëve të këshillit administrativ caktohen në statut.

Këshilli administrativ është organi administrativ i shoqërisë, i cili administron shoqërinë sipas orientimeve të vendosura nga asambleja e përgjithshme dhe jep llogari para saj. Këshilli administrativ thirret në mbledhje nga kryetari ose zëvendëskryetari jo më pak se një herë në muaj.

Kryetari i këshillit administrativ përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët. Në statut parashikohet mënyra e zëvendësimit të tij me anëtarë të tjerë të këshillit administrativ.

Anëtarët e këshillit administrativ të shoqërisë përgjigjen personalisht për dëmet që kanë shkaktuar për shkak të mospërmbyshjes së detyrimeve

Neni 29
Këshilli mbikëqyrës
(Ndryshuar me ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Këshilli mbikëqyrës është organ i kontrollit të shoqërisë mbi veprimtarinë administrative dhe financiare të saj. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë që zgjidhen prej asamblesë së përgjithshme nga radhët e anëtarëve të shoqërisë. Nëse është e nevojshme, asambleja e përgjithshme mund të zgjedhë më shumë se tre anëtarë për këshillin mbikëqyrës. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, edhe para përfundimit të periudhës kohore për të cilën është zgjedhur, bëhet nga asambleja e përgjithshme me tre të katërtat e votave të anëtarëve të pranishëm.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk lejohen që në të njëjtën kohë të jenë anëtarë të këshillit administrativ, me përjashtim të rasteve kur shoqëria përbëhet nga më pak se gjashtë anëtarë.

Këshilli mbikëqyrës nuk merr asnjë vendim dhe nuk mund të japë asnjë sanksion. Çdo vit ai i paraqet asamblesë së përgjithshme të zakonshme vjetore një raport për drejtimin e veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë. Këshilli mbikëqyrës mund t'i paraqesë një raport të tillë çdo asambleje të përgjithshme, ose mund të thërrasë një asamble të zakonshme ose të jashtëzakonshme për çdo problem të rëndësishëm që çmon se duhet diskutuar.

Këshilli mbikëqyrës mund të kërkojë në çdo kohë raport nga këshilli administrativ për veprimtarinë e tij dhe të shohë ose të ngarkojë anëtarët e tjerë për të parë dokumentet e shoqërisë.

Detyrat e tjera të këshillit mbikëqyrës përcaktohen në statut.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund t'ua delegojnë ushtrimin e detyrave të veta personave të tjerë.

Këshilli mbikëqyrës mund të pezullojë anëtarët e këshillit administrativ deri në një vendim të asamblesë së përgjithshme që thirret menjëherë dhe merr vendimet e duhura për shkak të vazhdimit të veprimtarisë.

KREU IV KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 30

Kapitali

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok ka kapitalin e saj, i cili përbëhet nga shuma e përgjithshme e pjesëve (kontributeve) që derdhen anëtarët e shoqërisë. Vlera e pjesëve të kapitalit caktohet në statutin e shoqërisë.

Neni 31

Përbërja e kapitalit

Kapitali i një shoqërie të bashkëpunimit reciprok është i përbërë nga një numër pjesësh (kontributesh) që janë nominative dhe që kanë secila të njëjtën vlerë.

Vlera e pjesëve të kapitalit, e caktuar në statutin e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok, në asnjë rast nuk mund të rivlerësohet, duke përfshirë në to fondet e rezervave të krijuara ose në çdo pasuri tjetër të krijuar nga shoqëria gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 32

Ndryshimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok mund të ndryshojë në rritje a në zbritje, në bazë të numrit të anëtarëve të shoqërisë dhe të pjesëve të kapitalit që ka çdo anëtar në kapitalin e shoqërisë.

Neni 33

Kufiri i uljes së kapitalit

Gjendja neto e kapitalit të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok përbëhet nga kapitali i saj dhe nga fondet e rezervave ose pasuritë e tjera që rezultojnë pas zbritjes së humbjeve të veprimtarisë së shoqërisë. Gjendja neto e kapitalit të shoqërisë nuk mund të ulet nën 3/4 e gjendjes neto maksimale të kapitalit të konstatuar nga një asamble e përgjithshme.

Neni 34

Nënshkrimi i pjesëve të kapitalit për pranim

Anëtari i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok duhet të nënshkruajë një ose disa pjesë të kapitalit. Pjesët e kapitalit të shoqërisë kanë vlerë të njëjtë. Numri i pjesëve për të qenë anëtar i shoqërisë caktohet në statutin e çdo shoqërie dhe nuk varet nga veprimtaritë që anëtari i shoqërisë kryen me shoqërinë. Ky numër është i njëjtë për çdo person që kërkon të pranohet anëtar i shoqërisë ose për çdo anëtar të pranuar.

Pjesët e kapitalit të nevojshëm për pranimin e çdo anëtari në shoqërinë e bashkëpunimit reciprok nuk shpërblehen.

Pjesët e tjera të kapitalit që nuk janë të nevojshme për pranimin e anëtarit në shoqërinë e bashkëpunimit reciprok, shpërblehen dhe janë të kthyeshme.

Neni 35

Pagimi i pjesëve të kapitalit

Në statutin e shoqërisë mund të parashikohen kushtet e nënshkrimit dhe të pagimit të pjesëve të kapitalit, për garanci të veprimeve që anëtarët kryejnë me shoqërinë e bashkëpunimit reciprok.

Neni 36

Shpërblimi i pjesëve të kapitalit

Asnjë e ardhur nga veprimtaria e shoqërisë nuk u shtohet pjesëve të kapitalit të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok.

Neni 37

Kontributi në natyrë

Pjesët e kapitalit të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok mund të jepen në lekë ose në natyrë. Ato shlyhen plotësisht, kur paguhen lekët ose kur kontributi në natyrë vlerësohet nga ekspertët përkatës dhe vihet në dispozicion të shoqërisë.

Neni 38

Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit të shoqërisë trashëgohen. Ato mund të blihen nga persona të tretë ose nga anëtarë të shoqërisë. Në këto raste transferimet e pjesëve të kapitalit duhet të autorizohen paraprakisht nga këshilli administrativ i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok.

Neni 39

Kushtet e kthimit të pjesëve të kapitalit

(Ndryshuar me ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Pjesa e kapitalit të shoqërisë, që i përket anëtarit që largohet nga shoqëria, përcaktohet sipas gjendjes së pasurisë të shoqërisë dhe numrit të anëtarëve. Ndarja bëhet në bazë të bilancit të fundit.

Neni 40

Regjistri i pjesëve të kapitalit

Çdo shoqëri e bashkëpunimit reciprok mban një regjistër me emrat e anëtarëve pronarë të pjesëve të kapitalit të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok. Në këtë regjistër shënohen datat e dhënies e të pagesës së pjesëve, si dhe ndryshimet e pronarit të tyre.

KREU V

DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 41

Veprimtaria financiare

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Veprimtaria financiare vjetore e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Bilanci vjetor duhet të kontrollohet nga një ekspert kontabël i miratuar, i cili caktohet nga asambleja e përgjithshme dhe ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme pa të drejtë vote.

Neni 42

Analiza e veprimtarisë

(Shtuar fjalë me ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Këshilli administrativ i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok harton raportin e administrimit, përpilon inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për kontabilitetin dhe ia paraqet për miratim asamblesë së përgjithshme, brenda një afati prej tre muaj deri në katër muaj, duke filluar nga data e mbylljes së veprimtarisë financiare vjetore.

Neni 43

Fondi i rezervës për mbulimin e rreziqeve

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok gjatë çdo veprimtarie fitimprurëse detyrohet të mbajë një shumë të hollash që përcaktohet në statut për krijimin e fondit për mbulimin e rreziqeve të veprimtarisë.

Këto rezerva mund të përdoren vetëm për mbulimin e humbjeve të shkaktuara nga rreziqet. Shoqëria e bashkëpunimit reciprok mund të parashikojë në statut, kur e shikon të nevojshme, krijimin e rezervave të tjera. Në këtë rast statuti përcakton shumën që do të paguhet për këtë fond dhe subjektin që përdor fondin.

Neni 44

Fondi i rezervës ligjore

(Shtuar fjalia e fundit me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003).

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok për krijimin e fondit të rezervës ligjore depoziton për çdo vit 1/10 (një të dhjetën) e fitimit neto të shoqërisë, derisa fondi i rezervës ligjore të barazohet me vlerën maksimale të kapitalit të konstatuar gjatë një asambleje të përgjithshme vjetore të shoqërisë së bashkëpunimit reciprok. Për këtë fond vendos asambleja e përgjithshme.

Neni 45

Fondi i rezervës së detyrueshme

(Shfuqizuar me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Neni 46

Fondi i rezervës fakultative

(Shfuqizuar me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Neni 47

Fondi i rezervës për interesin e pjesëve të kapitalit

(Shfuqizuar me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Neni 48

Mosprekja e rezervave financiare

(Shfuqizuar disa fjalë me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Rezervat e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok, ciladoqoftë natyra e tyre, nuk mund t'u shpërndahen anëtarëve të shoqërisë. Ato nuk u shpërndahen anëtarëve edhe në rastin e largimit të tyre nga shoqëria.

Neni 49

Përdorimi i fitimit neto

(Ndryshuar me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Asambleja e përgjithshme vjetore, pasi verifikon shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, të cilave u ka mbërritur afati i skadimit, vendos për përdorimin e fitimit neto, i cili do të përdoret vetëm për:

1. krijimin e rezervave të përcaktuara, sipas rregullave të statutit;
2. shpërblimet për veprimtarinë që anëtarët kanë kryer me shoqërinë e bashkëpunimit reciprok;
3. vlerën që do të paguhet për prodhimet dhe shërbimet e realizuara nga anëtarët e shoqërisë ose për të ulur kostot e blerjes së pasurisë, shërbimeve, si dhe për shlyerjen e kredive.

Në statut përcaktohet radha e mëtejshme e shpërndarjes.

Neni 50

Shpërblimet sipas veprimtarisë

Pjesa e fitimit e caktuar për shpërblimet e anëtarëve të shoqërisë mund t'u ndahet atyre vetëm në mënyrë përpjesëtimore me veprimet që ata kanë realizuar me shoqërinë e bashkëpunimit reciprok.

Neni 51

Mbulimi i humbjeve

(Ndryshuar fjalia e dytë me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Në rast se veprimtaria e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok del me humbje, ato mbulohen me fondet e krijuara posaçërisht për këtë qëllim. Kur këto fonde mbarohen, humbjet mbulohen nga rezervat ose fonde të tjera të parashikuara në statut. Në rast të mbarimit të rezervave, humbjet mbulohen nga kapitali i shoqërisë. Nëse ky kapital do të ulet, për këtë shkak më poshtë se tre të katërtat e shumës maksimale të kapitalit të konstatuar gjatë një asambleje të përgjithshme vjetore, prishja e shoqërisë do të shpallet nga asambleja e përgjithshme që konstaton këtë ulje, por vetëm nëse anëtarët e shoqërisë nuk do të vendosin të nënshkruajnë pjesë të reja të kapitalit, ose të rritin vlerën nominale të pjesëve a të japin brenda një muaji shumat përkatëse për të mbuluar humbjen. Pas këtij afati, nëse nuk veprohet për mbulimin e humbjeve, asambleja e përgjithshme njofton prishjen e shoqërisë.

KREU VI

REGJISTRIMI E MIRATIMI

Neni 52

Kërkesat për regjistrim

(Ndryshuar paragrafi i parë me Ligjin Nr.9747, datë 31.05.2007)

Kërkesa për regjistrimin e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok duhet të bëhet nga kryetari i këshillit administrativ të shoqërisë dhe depozitohet pranë organit të ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin. Aplikimi për regjistrimin e shoqërisë duhet të paraqitet së bashku me statutin e saj. Firmat që figurojnë në kërkesën për regjistrimin e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok dhe firmat që figurojnë në statutin e saj, duhet të vërtetohen si autentike nga noteri.

Neni 53

Plotësimi i regjistrimit

(Shfuqizuar paragrafi i parë me Ligjin. Nr.9747, datë 31.05.2007)

Deklarohen dhe regjistrohen lloji, kohëzgjatja, nëse kjo është përcaktuar, emërtimi, selia, objekti i veprimtarisë, vlera e pjesëve të kapitalit dhe emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vendlindjet e anëtarëve të këshillit administrativ.

Depozitohen në aneksin e regjistrimit kërkesa dhe statuti i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok.

Neni 54

Miratimi

(Ndryshuar me Ligjin. Nr.9747, datë 31.05.2007)

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok regjistrohet pranë organit të ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e tyre.

Procedurat, afatet e regjistrimit dhe procedura ankimore kundër vendimit, që refuzon regjistrimin e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok, rregullohen sipas procedurave të parashikuara me ligj të veçantë.

KREU VII

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 55

Përfundimi nga tatimet

(Ndryshuar me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok është e tatueshme. Përfundohen nga tatimet shoqëritë e bashkëpunimit reciprok në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral për pesë vitet e para të

veprimtarisë së tyre. Këto shoqëri e humbasin këtë të drejtë kur ato bashkohen me shoqëri të tjera që nuk janë të përjashtuara nga tatimet.

Neni 56
Shpërndarja

Shpërndarja e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok mund të bëhet me vendim të një asambleje të përgjithshme të jashtëzakonshme ose mund të shpallet nga një asamble vjetore, e cila konstaton uljen e kapitalit social më poshtë se tre të katërtat e shumës maksimale të kapitalit të konstatuar nga një asamble e përgjithshme vjetore. Likuidimi kryhet nga një likuidues i caktuar nga asambleja që ka vendosur shpërndarjen.

Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet edhe me mbarimin e afatit të saj, me realizimin e objektit të shoqërisë, me vullnetin e gjithë anëtarëve ose për shkaqe të parashikuara në statutin e saj.

Neni 57
Likuidimi

Likuidimi i shoqërisë bëhet nga një ose disa likuidues të emëruar nga asambleja e përgjithshme që ka vendosur shpërndarjen e shoqërisë. Detyrimet dhe përgjegjësitë e likuiduesve rregullohen në bazë të rregullave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 58
Përdorimi i kapitalit për kthimin e borxheve

Kapitali i shoqërisë dhe fondet e saj gjatë likuidimit të shoqërisë përdoren përparësisht për të paguar detyrimet e shoqërisë. Pjesët sociale të kapitalit të shoqërisë paguhen pjesërisht ose tërësisht, vetëm pasi të jenë paguar të gjitha detyrimet e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok ndaj të tretëve.

Neni 59
Përgjegjësia financiare e anëtarëve të shoqërisë

Në rastin kur detyrimet e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok nuk mund të shlyhen me pasurinë e saj që rrjedh nga likuidimi, anëtarët e shoqërisë përgjigjen për detyrimet e pashlyera deri në dyfishimin e vlerës nominale të pjesëve të tyre që kanë në kapitalin e shoqërisë të përcaktuara në statut.

Neni 60
Mbetjet pas likuidimit
(Ndryshuar me Ligjin Nr.9039, datë 27.03.2003)

Pas likuidimit të të gjitha detyrimeve dhe pagesës së pjesëve të kapitalit, në rast se rezulton një mbetje, ajo ndahet ndërmjet anëtarëve të shoqërisë.

Neni 61
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1442, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha